



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 35-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 29.11.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shefki Bytyqi, anëtar
3. Gazmend Qerkini, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Fadil Sopa, anëtar
7. Sami Bytyqi, anëtar
8. Fitim Shala, anëtar
9. Xhyzide Rustemi, anëtare
10. Rinor Murati, anëtar
11. Armend Grajqevci, anëtar
12. Gentianë Hoxhaj, anëtare
13. Venhar Agushi, anëtar
14. Xhyla Dedushaj, anëtare
15. Lulzim Rustemi, anëtar
16. Herolind Kozhani, anëtar
17. Ardit Cani, anëtar
18. Arsim Jashari, anëtar
19. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
20. Ganimete Qeriqi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Fitim Meziu, anëtar
23. Fadil Spahiu, anëtar
24. Fatmir Fetahu, anëtar
25. Shahadije Dragaçina, anëtare
26. Besiana Sylja, anëtare
27. Enver Kryeziu, anëtar
28. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i komunës
4. Latif Ramadani, DBF
5. Shkelzen Hajdini, DSHMS
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Valon Pacolli, DEZH
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DKA
11. Safete Amerllahu, DGJK
12. Burim Rrustemi, DSHPMSh
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-Llugiqi, DKRS
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se uroj që jeni mirë, pastaj siç po e shihni salla e kuvendit është bërë me ngjyrë portokalli. Jemi ne 16 ditëshin për ti thënë stop dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje. Në emër tuajin dhe të anëtarëve të kuvendit urojmë që mos të këtë kurrë raste të tilla. Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 34-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK-Lipjan. (Rishqyrtim).
3. Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit 2024-2029.
4. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr.15-462/01-35825 datë 25.07.2024 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në ZK Magurë.
6. Diskutimi i Planit të veprimit për adresim të rekomandimeve të ZKA nga Raporti vjetor për PVF 2023.

7. Diskutimi i Raportit të Auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve për auditimin e kryer në Sektorin e tatimit në pronë.

Pastaj Kryesuesi i kuvendit hodhi në votim propozimin dhe pas votimit u konstatua se me 22 vota për, u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Albiona Tasholli, tha se pasi që jemi në 16 ditëshin e dhunës në bazë gjinore edhe unë ju bej thirrje të gjithë qytetarëve për reflektim dhe veprim. Te gjithë kemi një veprim të përbashkët ti themi stop dhunës. Është detyrë e jona kolektive që ta ndalojmë dhunën në baza gjinore. Çështja e parë që dua të diskutoj ka te bejë me rrugën “Raif Tasholli” e cila ende mbetet e pa zgjidhur edhe pas ndërhyrjeve te kahershme të komunës, pasi që çdo herë pas reshjeve të shiut, bie rëra ne rrugë dhe rruga bllokohet nga grumbullimi i rërës dhe kjo po shkakton probleme ne komunikacion. Kërkesa tjetër ka te bejë me disa shtylla elektrike te cilat kane ra në rrugën Raif dhe Ibush Tasholli, pas ndërhyrjes se KEDS-it, kanë mbet kabllot në tokë, kërkoj nga drejtoria përkatëse të intervenoj.

Gentianë Hoxhaj, tha se e kam një pyetje për ekzekutivin kur do të lëshohet parkingu dhe nënkalimi pasi që tani vijnë edhe mërgimtarët.

Arsim Jashari, tha se së pari ua uroj festat e nëntorit te gjithëve, po ashtu në emër te grupit e mbështesim aktivitetin e 16 ditëve kundër dhunës në familje. Ne kemi nda mjete në buxhet për mbrojtëse te urave neper fshatra, pse që nuk janë vendos ende këto mbrojtëse të urave. Kërkesa e dytë rrethojat te shkolla e vjetër Banulle-Gllogovc janë 300 apo 400 metra rrethoja të cilat janë ne gjendje shumë te mire, kane filluar me i vjedh. Është mirë me ndërmarr masa. Te kujdesi i pasurisë publike ne po dështojmë, pasuria publike po dëmtohet çdo dite dhe nuk po ndërmerr masa askush. Dhe ne prapë pas disa viteve po detyrohemi me investuar. Te mirëmbajtja e investimeve është ne gjendje shume të keqe nëse del me shikuar nëpër fshatra janë ne gjendje te mjerueshme.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se është një rrugicë ne mes te rrugës “Zylfije Gashi” dhe “Isa Olluri” kompania Xhema ka punuar për rregullimin e kanalizimit, mirëpo e ka dëmtuar rrugën gjatë punimeve. Pra kompania e ka lënë ne gjendje te mjerueshme rrugën e cila është e pa kalueshme. Është dashtë që kjo kompani ta kthej në gjendjen si ka qenë ajo rrugë. Kur do te riasfaltohet ajo rrugë. Çështja e dytë në fshatin Varigovc për ditë të tera nuk ka energji elektrike një fazë. Edhe shkolla ka mbet pa energji elektrike. E di që nuk është kompetence e komunës, por komuna nuk

duhet me mbet indiferentë ndaj kësaj çështje. A ju keni drejtuar me një kërkesë KEDS-it, për këtë çështje, pasi që është keq me mbet pa rryme në këtë kohë kur terrohet herët. Tjetra këto ditë jemi në 16 ditët e aktivizimit të dhunës në familje është lansuar një spot ku janë përfshirë të gjithë akteret, mirëpo jo edhe kuvendni i komunës. Është dashtë që të përfshihen ndonjë anëtar i kuvendit, shef i grupit, apo të paktën kryesuesi i kuvendit, sepse kjo është një injorance ndaj organit më të lartë kuvendit. Kërkoj nga ana juaj kryesues që mos bëhen gjëra të tilla.

Herolind Kozhani, tha se kam disa çështje, e para a do të vendosen semaforët në rrugën "Haradin Bajrami" pasi që jemi në prag të festave të fund vitit dhe kemi rritje të numrit të mërgimtarëve. E dyta kam informacione se kompania punëkryese i ka ndal punimet të nënkalimi dhe parkingu nëntokësor, a mundemi me i dite arsyet pse janë ndal punimet? Dhe të bus stacionet ka nevojë për asfaltim pasi që nuk janë në gjendje të mirë. Po ashtu gjendja e lumenjve është shumë e rëndë, duhet të bëhet mirëmbajtja e tyre.

Lulzim Rrustemi, tha se unë i kam tri pyetje, qendra multifunksionale ose shtëpia e kulturës në Lipjan a është zhvilluar ndonjë procedure deri ku kemi mbërritur si projekt. Projekti i ujësjellësit në fshatrat, Hallaq i Madh, Varigovc, Ribar i Madh, Kraishtë, ku ka mbetë, në cilin stad të zhvillimit është. Tjetra ura mbi lumin Sitnica në Rufe, të rruga "Marie Shllaku" çka po ndodh me atë urë kur pritet të përfundohet.

Bashkim Budakova, tha se çështjen që do ta ngris është, ka të bëjë me qentë endacak ku ky problem është adresuar disa herë në kuvend, mirëpo kohëve të fundit është bërë goxha serioz. Vetëm këtë muaj dy persona janë sulmuar nga qentë endacak në rrugën "Isa Olluri" ku njeri prej tyre është nxënësi i shkollës fillore. A ka diçka rreth kësaj çështje.

Shahadije Dragaçina, tha se pasi që jemi në 16 ditëshin kundër dhunës në familje, kisha dashtë që kryesuesi të marrë iniciativë që QPS-ja, të raportojë në kuvend në muajin nëntor çdo vit dhe në anëtarët e kuvendit të jemi të njoftuar me shifra rreth rasteve të dhunës. Ne urojmë që të ketë sa më pak raste të tilla. Tjetra në kuvend kryetari ka deklaruar që në muajin tetor do të fillojë renovimi i shkollës së Janjevës. Dua të pyes se a ka filluar ky renovim. Çështja tjetër çka është duke ndodhur me projektet e qytetit, ku në qytet është duke ndodhur një krahur dhe gjendja është shumë e keqe e sidomos tani kur vijnë mërgimtarët. Çka është duke ndodhur me kanalizimin në hyrje të fshatit Llugaxhi edhe pse kjo çështje është ngritur disa herë në kuvend. E fundit një qytetar është ankuar se në fshatin Gumnasellë se është gjendje e rrugës shumë e keqe dhe komuna nuk ka ndërmarr masa.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se sa i përket informatës se këshillit, ne e kemi paraparë që ne muajin dhjetore të kemi një informatë në muajin dhjetor, së bashku me kryesuesen e këshillit. Sa i përket videos akteret që kanë dhënë mesazh janë pjesë e këshillit.

Alban Salihu, tha se mirëmbajtja e investimeve edhe pse u ngrit më herët dhe nga asambleistët e tjerë, këtu situata ka eskaluar ku shumë projekte nuk po mirëmbahen, qoftë rrugë, kanalizime, trotuare. Ne jemi çdo ditë në teren dhe gjendja nuk është e mirë. Çështja tjetër e organizimit për festat e nëntorit, nëse e krahasojmë me komunat e tjera po qalojmë nuk po ka organizime dinjitoze. Në të shumtën e rasteve po janë të zbehta. Lipjanit i mungon një shtëpi e kulturës. E fundit që 36 muaj po qeverisë kryetari dhe e lus që 36 paga që i ka marr, të ia kthejë qytetarëve të komunës së Lipjanit. Për shkak se nuk po e ushtron detyrën si kryetar i komunës dhe nuk jeton në Lipjan dhe po qeverisë me korrespondencë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha se kryetari çdo ditë është në komunë dhe punën e tij e vlerësojnë qytetarët dhe organizatat e ndryshme, qoftë vendore apo ndërkombëtare. Dhe duhet me ju gëzuar faktit që si komune dalim çdo herë mirë si në raportin e auditorit, apo edhe të organizatave të ndryshme. Nuk e di çka po ju pengon juve kryetari që është sekretari i partisë, dhe njeri i dytë në parti. Kryetarin çdo ditë e kemi në punë.

Egzona Bytyqi, tha se unë i kam tri çështje që kanë të bëjnë me shëndetësinë, këto ditë janë kryer trajnime për disa mjekë sa i përket ekografisë. Dua të di nëse ky trajnim ka qenë gjithëpërfshirës. Pyetja tjetër QMF-të, a kanë me u pajis me ultrazë. Tjetër, a është paraparë të bëhet zgjerimi i analizave, duke e përfshirë edhe atë të gjëndrës tiroide. Komunës tonë me shumë mungon ngrohtësia e qytetit, me sa e di kryetari i komunës ka pas një takim me një organizatë holandeze, ku ata kanë kërkuar që me bërë fizibilitetin e sistemit të ngrohjes. A ka diçka të re për këtë çështje? Tjetra ka të bëjë me shkollën e vjetër në Magurë, ajo shkollë që disa vite është jo funksionale dhe dita e ditës po demolohet. A keni menduar diçka për atë shkollë. Rekomandoj që ajo shkollë të rënohet dhe të ndërtohet çerdhja në atë lokacion. Sa i përket spotit unë nuk jam ndier mirë, me shumë ka qenë një spot për promovim individual. Në atë spot më shumë ka pas figura nacionale, gabimi është njerëzor dhe herët tjera duhet më reflektuar dhe mos me u bërë kështu gabime.

Rinor Murati, tha se kam disa kërkesa për ti adresuar, e para sa i përket stacioneve pritëse për autobus dhe taksi konsideroj një nevojë e cila duhet të realizohet. Kam disa pyetje, e para për drejtorinë e Arsimit a do të ketë thirrje për

ndarje për bursa për student për këtë vit. E dyta për drejtorinë e kulturës, e kemi pare se është zhvilluar një takim i KF Ulpiana, çfarë hapa janë ndërmarr në atë takim. Dhe ne fund i falënderoj te gjithë qytetaret për bashkëpunimin e deritanishëm.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës, tha se edhe ne si ekzekutiv i bashkohemi thirrjes për bashkim kundër dhunës ne baza gjinore dhe dhunës ne familje. Spoti ka qenë një organizim prej organizate, dhe ka qenë një mesazh prej anëtareve të këshillit, ku është dhënë një mesazh edhe nga kryetari por edhe unë si nënkryetar. Te rruga “Raif Tasholli” në Gadime kemi ndërhyrë disa here, por aty duhet një ndërhyrje me afatgjatë. Sa i përket kablllove inspektorati ka dal ne vendin e ngjarjes e ka njoftuar KEDS-in, Çështja e nënkalimit ka filluar qe 1 vit si projekt do te përfundoj sa me shpejt qe mundemi. Mirëmbajtja e hapësirave publike, ne kemi disa kontrata për mirëmbajtje. Sa i përket rrethojave te shkolla ne do te marrim perisiper rrethojat dhe do ti ruajmë te depot tona. Te rrugica te “Zylfije Gashi” do te ri asfaltohet shume shpejtë. Kërkesa e rrymës jo vetëm për Varigovc, por edhe për vendet tjera ne kemi bere disa herë kërkesë por ajo është kompetencë e KEDS-it. Kërkesa për semafor ne rrugën “Haradin Bajrami”, një kemi provuar me semafor por nuk është qe ka funksionuar ne bazë te ekspertëve. Do të shohim tani ndoshta mundet te jete një rreth rrotullim ne atë vend. Bus stacionet në fshatra ka qenë një propozim i KFORIT Turk për ti vendosur por ende nuk kemi diçka prej tyre. Ne do te shohim ne vitin e ardhshëm si është mundësia për vendosje te bus stacioneve nëpër fshatra. Sa i përket lumenjve kontrata është në OSHP. Edhe për shtëpi te kulturës lëndën e kemi ne OSHP. Ura mbi lumin Sitnica te “Marie Shllaku” është ne vlerësim. Sa i përket qenve endacak kemi shpalle tenderin dhe shume shpejt do te lidhet kontrata. Sepse është një shqetësim jo vetëm i joni por nacional. Shkolla ne Janjevë shumë shpejtë do të filloj. Çështja e kryetarit, po e shihni qe është në zyre dhe po e shihni qe është edhe tani në salle. Sa i përket ngrohtores se qytetit organizata është zotuar qe do ta mbështes studimin e fizibilitetit qe është hapi i parë, por është një projekt i kushtueshëm. Shkolla ne Magurë, ka pas një me u ndërtua një çerdhe në bazë të vendim te Kuvendit, besoj qe momentin qe marrim përgjigje nga ministria do ta e realizojmë si projekt. Bursat jemi ne proces te ndryshimit te rregullores për bursa ne mënyrë qe te përfshihen edhe ata qe studiojnë jashtë shtetit. Klubi Ulpiana ka kaluar një faze te vështirë te funksionimit, ata kane thirre një kuvend te jashtëzakonshëm dhe kemi përshëndet atë kuvend, dhe pritet te kthehet nga OJQ ne shoqëri aksionare.

Shkelzen Hajdini tha se, po është një grup i mjekeve në trajnim për ekografi, do te vazhdojmë edhe grupe e tjera me radhë. QKMF do pajiset me një ekografi. Sa i përket zgjerimit të analizave edhe te gjëndrave tiroide do të bëhen edhe ato mundësia

e pare qe na ipet. Ne sot i ofrojmë 42 analiza në QKMF, disa prej tyre edhe ne QMF. Do ti përfshijmë edhe gjëndrat tiroide shumë shpejtë.

Alban Salihu, tha mua nuk me pengon fakti qe kryetari eshët sekretar i partisë, për kundarzi me gëzon sepse kështu e kanë pru LDK-në, 12 në përqindje.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha ju kisha lut qe mos e keqpërdori foltoren sepse ka rregulla edhe ne kuvend, te caktuara ne baze te rregullores se punës se kuvendit, është mire me lexua rregulloren.

Egzona Bytyqi, tha se çdo investim ne sektorin e shëndetësisë e kam thënë disa here po e them prape qe mua me gëzon pa mase. Këto adresimet qe i thash me herët i pata ngrit edhe ne dëgjime buxhetore. Sa i përket spotit ka qenë puro politik. Eshtë dashtë me dhënë një mesazh drejtori i DKA-së, drejtori i shëndetësisë, për këtë temë, po ashtu, asnjë anëtarë i kuvendit as nga pozita e as opozita nuk janë pjesë e këtij spoti. Gjithashtu edhe anëtarët e këshillit kanë fol në spot kanë qenë te selektuar.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se kush donë me më pa mua, unë jam ne pune çdo ditë, dhe këtë mund ta vërtetoni. Nuk e kam dert çka mendoni ju, këtë e vlerësojnë qytetaret. Sa i përket spotit e ka bere një kërkesë për financim një organizatë dhe ne e kemi financuar dhe ajo e ka bere atë spot. Unë nuk e kam shikuar atë spot ndoshta mund te këtë edhe gabime te tilla. Te shkolla e Magurës ne e kemi nda lokacionin për çerdhe po ashtu edhe për Banullë, por ministria nuk na ndihmuan me ndërtuar çerdhe. Përgjigjja e tyre ka qen vetëm ne qytet nëse doni me ndërtuar. Ky është fati i këtyre dy çerdheve. Ne disa lëndë i kemi në OSHP ,sepse ligji e jep fitues më të lirin. Fondi eficient nuk ka lidhje me ministri, kjo është konkurrencë ne mes te komunave, ne e kemi fituar atë, për renovimin e shkollës në Janjeve dhe fasadimin e banesave ne qendër te Lipjanit

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 34-të e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 27 vota për aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 34 të, e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK- Lipjan. (Rishqyrtim).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj pas pauzës Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne fillimisht e kemi kundërshtuar këtë propozim vendim. Për here te pare mendoj qe arsyetimi i ministrisë është në rregull, këtu po e specifikon sakte, kur e jep një prone sa ka me qenë përfitimi i komunës sa metra kane me u dhënë është e specifikuar, kjo duhet me u ditë. Kam pyetje a është gabim i juaji këtë here.

Alban Salihu, tha se zyra ligjore e MAPL-së, ka krijuar një keqkuptim këtu, pasi qe këtu asnjëherë nuk ka qene qëllimi me përfituar komuna e Lipjanit, por qëllimi ka qene me përfituar shokët dhe miqtë e kryetarit.

Imri Semetishti, tha se a kemi qene ne gabim nuk mund ti shmangem përgjegjësisë, realisht nuk kam qen i kyçur ne këtë, kanë qenë të përfshira zyra ligjore dhe zyra pronësorë, ju kanë referuar praktikes deri te me tanishme.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 7 kundër, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit 2024-2029.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se një material voluminoz, parimisht nuk jemi kundër kësaj strategjie, por do te abstenojmë. E para te dhënat dalin ne dhjetor nga Agjencia e Statistikave, aty ku dihet sa ekonomi familje i kemi, sa te shkolluar sa te pa shkolluar, ndërsa ju jeni bazuar ne të dhëna gojore te cilat mund te jen te pa sakta. Pse e keni parapa 2024 -2029, çka nëse na kthehet mbrapa nga ministria, ne dalim 2025-2030 . Ne fillimisht do te abstenojmë.

Rinor Murati, tha se sa i përket strategjisë, konsideroj qe është një dokument mjaft i rëndësishëm, me te gjitha informatat qe i posedon për njohuritë e gjithë secilit,

për çka e përgëzoj grupin punues për punën. Në emër të grupit të LDK-së e mbështesim, këtë propozim.

Lulzim Rrustemi, tha me qenë se është një dokument me rendësi të veçantë, për ti dhënë kahje zhvillimit të Lipjanit. Kjo strategji nuk është e duhura dhe e përshtatshme për pesë vjetorin e ardhshëm të komunës të Lipjanit, për këto arsye: E para ka të dhëna jo kredibile duke i marr ne të dhëna nga statistikat e vitit 2011, ndërsa tjerat i keni marr ne mënyre të konsultueshme. Dhe 50 faqe të kësaj strategjie janë përshkrim. Objektivat janë mjaft të qëlluara por janë të thata të pa përmbushura, nuk përmendet zona e ekonomike e QMI-së, as zona e Babushit, përveç parkut të Qylagës. Nuk përmenden fare as ujësjellësi, as kanalizimi, trajtimi i ujerave të zeza, arsimit e shume çështje tjera. Te turizmi si objekt qëndron në shesh, por nuk funksionon fare. As për ujin e ngrohte në Bainsë, as për shpellën e Gadimes nuk ka asgjë.

Valon Pacolli, tha se ka qenë në konsultim publik kjo strategji dhe keni mujt me i dhen kontributin tuaj, kjo e përfshin fushën e ekonomike Ne ju kemi përmbajt edhe referimit të MAPL-së, disa aktivitete i kemi larguar për shkak të kostos së tyre. Ne grup punues përveç neve kanë qenë anëtar edhe nga MAPL dhe ne kemi marr miratim paraprak nga MAPL-ja.

Rinor Murati, tha se pasi u përmenden zonat ekonomike që mungojnë, por siç shihet në strategji janë përfshirë të gjitha zonat ekonomike duke e përfshirë edhe atë në Konjuh dhe në Babush.

Arsim Jashari, sa i përket strategjisë ju vet e keni cek në faqe 11 të kësaj strategjie ku thuhet se sfida kryesore ka qenë mungesa e të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullsisë ekonomike familjare dhe banesave. Jemi 11 vite mbrapa, unë e kam një propozim të shtyjmë edhe 2 jave presim të dalin statistikat nga ASK-ja, dhe pastaj e votojmë. Qëllimi është të këtë përmbajtje kjo strategji, sepse ne nuk jemi kundër kësaj strategjie.

Daut Azemi, tha se ne nuk mundemi me parashikuar se sa banorë do të kemi pas disa viteve në Lipjan, apo në fshatra.

Valon Pacolli, sa i përket strategjisë ne jemi bazuar në të dhënat preliminare të cilat i ka publikuar ASK-ja. Po ashtu kemi të dhëna edhe prej ATK-së ARBK-së. Nuk janë të dhëna nga vitin 2011

Lulzim Rrustemi, tha se unë nuk e kundërshtova ligjshmërinë, por e kundërshtova përmbajtjen. Pasi që nuk është konkrete dhe konkretizimi mungon këtë strategji.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 12 abstenime, aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr.15-462/01-35825 datë 25.07.2024 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtori për DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë e kam analizuar mire këtë propozim, edhe ligjin e kam konsultuar. Është keq që ligji nuk ja mundëson te dytit, ne si grup do të abstenojmë këtë propozim.

Alban Salihu, tha se ne e kemi diskutuar edhe ne KPF këtë propozim, dhe e kemi kundërshtuar, sepse kemi pas vërejtje për krejt procesin si ka shkuar. Ne si grup do të abstenojmë këtë propozim vendim.

Lulzim Rrustemi, tha se nuk e kemi komplet lenden, këtu nuk e pash që është kontrata. E dyta ju e dini që deri te ardhja e kontratës të këtyre pronave ,kanë marr kohe shume ,shumë analiza dhe ne fund u tërheq.

Rinor Murati, tha se operatori fitues duhet ti këtë parasysh edhe afatet ligjore ne procedura dhe një arsye e tilla nuk është e qëndrueshme. Dhe për raste te tilla duhet te këtë edhe ndëshkim.

Valon Pacolli, tha se është bere një pune voluminoze, ne si komision nuk e kemi dite që mund te na ndodh një gjë e tillë që te tërhiqet fituesi.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha nuk është arsye e operatorit vonesa, sepse ka mujt ma herët me u tërheq. Por ne si kuvend duhet me shfuqizuar dhe në të ardhëm duhet me pas një lloj penalizmi për raste te tilla kur tërhiqen.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për, 13 abstenim aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në ZK Magurë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, a ka pas interesim paraprak për këto prona apo vetëm pse kane qenë te lira të pa shfrytëzuara. .

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se nuk ka pas interesim për këta prona por pasi qe kane qene te lira janë dal në shfrytëzim.

Gentianë Hoxhaj, tha se në emër të grupit të LDK-së, për anëtar të këtij komisioni e propozojmë, Fitim Shala.

Arsim Jashari, tha se në emër të grupit të PDK-së, për anëtar të këtij komisioni e propozojmë, Lulzim Rrustemin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit. Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 6 abstenim, aprovoi propozimin

VI

Diskutimi i Planit të veprimit për adresim të rekomandimeve të ZKA nga Raporti vjetor për PVF 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safet Krasniqit auditor i mbrenshem i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Besiana Sylja, tha se ne bazë të raportit të auditorit edhe pse opinionimi është i pa modifikuar, do te thotë qe nuk është gjithçka ne rregull pasi qe i kemi 5 rekomandime te reja, 3 te përsëritura dhe një shumë here i përsëritur. Gjithsej 9 rekomandime. Rekomandimi i cili vazhdimisht përsëritet ka te beje me pagesat e furnitorëve me

vonese me shume se 30 ditë. Pse keni hyrë ne obligime pa zotim? Pse po përsëritet ky rekomandim? Dhe pse nuk po kryhet pagesat brenda 30 dite?

Arsim Jashari, tha se e di qe e ka obligative avokati me bo përgjigje ne padi, kur ka padi. Por pse po bëni ne shkallen e dyte ankese, pse po bëni shpenzime. Pse po e dëmtoni komunën. Është mirë ne shkallen e pare me përfunduar.

Safet Krasniqi, tha gjate rishikimit qe e kemi bere ne nuk kemi gjete, sa i përket rekomandimit te përsëritur, po përballemi me përmbarues pa dëshirën tone dhe mjetet e zotune po merren pa dëshirën tone. Është procedure qe përdorë avokati edhe shkallen dyte.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua ne piken në vazhdim.

VII

Diskutimi i Raportit të Auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve për auditimin e kryer në Sektorin e tatimit në pronë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safet Krasniqit auditor i mbrenshem i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se kam një pyetje se sa janë të përgjegjshëm pronaret e pronave komunale ne pagesat e tyre, lokalet afariste, bujqësia tregjet. A keni bërë auditim te mbrëmshëm për këto.

Safet Krasniqi, tha se ne kemi berë auditime dhe kemi të gjeturat tona. Ne ju kemi qas të hyrave te cilat arkëtohen nga pronat komunale, hapësirat publike, hapësirat për taks, dhe kemi marr mostra për çdo kategori. Sa i përket tregjeve ka të hyra te mjaftueshme. Te hyrave nga lokalet ka një numër qe nuk kane bere pagesën por përmes përmbaruesit janë arkëtuar të hyrat.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 13:10.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi